



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 24-36 MUAJ **MUAJI NËNTOR**



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

 Fëmijët e Tiranës

<http://femijetetiranes.al/>

 femijet_e_tiranes

Kuriozitete për Muajin Nëntor



Çfarë mund të dimë për Nëntorin?

- * Muaji Nëntor është **muaji i tretë** i vjeshtës.
- * Në Nëntor, **ditët bëhen më të shkurtra** dhe më të ftohta se ditët në Tetor.
- * Frutat si **mandarinat, portokallet, shegët, hurmat**, ne nisim t'i shijojmë në Nëntor.
- * Nëntori është **muaji i Të Drejtave** të fëmijëve.
- * Nëntori është **muaji i festave kombëtare** të vendit tonë: Dita e Pavarësisë dhe Dita e Çlirimit.

Muaji Nëntor

Tema: Njohja e Vetes dhe Të Drejtat e Fëmijëve

Grupmosha 18-36 muaj



- * **Java I:** Njohja e vetes
- * **Java II:** Veshjet për fëmijët
- * **Java III:** Të drejtat e fëmijëve
- * **Java IV:** Festat dhe festimi i tyre



Tema e Muajit: Njohja e Vetes dhe Të Drejtat e Fëmijëve



Tema e Javës	Qëllimi	Koha
Njohja e vetes	Njohja me elementët e vetes	Java I
Veshjet e fëmijëve	Njohja me veshjet për fëmijë	Java II
Të drejtat e fëmijëve	Njohja me të drejtat e fëmijëve	Java III
Festat dhe festimi i tyre	Festojmë festat së bashku	Java IV




- * Stafi edukator duhet të marrë pjesë në çdo aktivitet dhe temë ditore bashkë me fëmijët.
- * Stafi i praktikon aktivitetet në bazë të zhvillimit dhe interesave të fëmijëve.
- * Stafi duhet të informojë prindërit mbi temën mujore dhe javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre





dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.






Tema e Muajit: Njohja e Vetes dhe Të drejtat e Fëmijëve
Tema e Javës: Njohja e Vetes








Java I	Tema	Aktivitetet	Mjetet
E Hënë	Fytyra ime 	Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve shqisat dhe i nxit ata të tregojnë pjesët e fytyrës duke i pyetur. Vjersha: “Këtu jam unë” Aktivitet: Shqisat Edukatorja përgatit vizatime të shqisave dhe ua tregon fëmijëve. Më pas, ulet në tavolinë përballë tyre dhe i vendos figurat që fëmijët t’i shohin qartë. Afër secilës figure vendos nga një objekt: p.sh. afër syrit vendos një libër; afër veshit magnetofonin; afër hundës një lule natyrale; afër gojës një frut. Edukatorja tregon funksionet e shqisave, duke e lidhur me objektet e zgjedhura. Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin shqisat.	Letra, lapsa me ngjyra, pasqyrë 

		<p><i>Shënim: Kërkojmë bashkëpunimin e prindërve për të sjellë foto të fëmijëve për aktivitetin e së premtes.</i></p>	
<p>E Martë</p>	<p>Trupi im</p> 	<p>Ushtrime: Fëmijët imitojnë ushtrimet gjimnastikore.</p> <p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve pjesët e trupit dhe më pas i pyet: Ku është dora/ këmba/ barku, etj? Ku e ke dorën Ema? Sa duar/ gishta/ këmbë kemi? (vijon me numërimin e tyre).</p> <p>Aktivitet 1: Me forma gjeometrike ndërtojmë trupin e njeriut: Koka (rrethi), trupi (katrori, drejtkëndëshi), këmbët, duart (trekëndësha). Mund të përdorim edhe mjete të riciklueshme si tapa, pipëza, etj.</p> <p>Ngjyrosje: Vizatojmë pjesët e trupit sipas formave gjeometrike dhe fëmijët i ngjyrosin ato.</p> <p>Vjersha: “Këtu jam unë”</p>	<p>Forma gjeometrike (petëza, kartona), pipëza, tapa, lapsa me ngjyra</p>  

<p>E Mërkurë</p>	<p>Në pasqyrë jam unë!</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja përdor pasqyrën për t'i ndihmuar dhe nxitur fëmijët të tregojnë dhe të flasin për veten, për tiparet e fytyrës dhe trupit, p.sh. “Perla ka flokë të verdha; Dreni ka veshur një bluzë kafe.”</p> <p>Aktivitet: “Gjurma ime”</p> <p>Paraprakisht, edukatorja përgatit brumë për aktivitetin. U jep fëmijëve një sasi brumi dhe ata punojnë individualisht në tavolinë për t'i dhënë forma të ndryshme (pjesa 1). U japim fëmijëve fleta të bardha ku ata do të ngjisin brumin dhe do të lënë gjurmën e dorës. Sipas dëshirës, gjurmën mund ta ngjyrosin ose ta dekorojnë (pjesa 2).</p> <p>Vjersha: “Këtu jam unë”</p> <p>Kënga: “Nëse ti je i lumtur...”</p>	<p>Pasqyrë, miell/brumë, penela</p> 
<p>E Enjte</p>	<p>Emri im</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve se të gjithë njerëzit kanë një emër. Emri vendoset kur ne vijmë në jetë. Edukatorja pyet çdo fëmijë për emrin dhe nxit dialogun për mësimin e emrave të njëri-tjetrit.</p> <p>Loja: “Gjej shokun/ shoqen”</p> <p>Fëmijët qëndrojnë në këmbë, edukatorja mbulon një fëmijë me çarçaf dhe pastaj e zbulon dhe pyet për emrin: Kush është ky/ kjo? Si e ka emrin? (pjesa 1)</p> <p>Pastaj mbulon nga një fëmijë me çarçaf dhe pyet grupin “Kush mungon? Cili fëmijë ndodhet këtu? A e gjeni dot?” (pjesa 2)</p> <p>Përralla: “Biskota e fundit”</p>	<p>Libër me përralla, çarçaf/ mbulesë</p> 

Java II	Tema	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>“Unë jam Vajzë” “Unë jam Djalë”</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve se kur vijnë në jetë jemi <i>vajzë</i> ose <i>djalë</i> pastaj i pyet ata: Po ti çfarë je... vajzë apo djalë?</p> <p>Lojë: “Loja e ekuilibrit” I ndajmë fëmijët në çifte vajzë-djalë. Çdo çift mban një shami me të dyja duart dhe në shami vendoset një top. Loja synon që fëmijët të mbajnë ekuilibrin teksa ecin përgjatë një distance. (Mund të organizoni edhe lojëra të tjera duke i ndarë fëmijët në grupe sipas gjinisë)</p> <p>Vjersha: “Jam një vajzë simpatike”/ “Çdonjëri prej nesh është i bukur”</p>	<p>Topa lodër, shami letre ose rrobe</p> 
<p>E Martë</p>	<p>Rrobat e mia</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u flet fëmijëve për veshjet dhe i emërton ato: bluza / tutat/ fundi/ fustani/ xhaketa/ çorapet/ këpucët, shalli, kapelja etj. Edukatorja pyet: Çfarë ke veshur ti... Arba? Po ti, Joni?</p> <p>Vjersha: “Jam një vajzë simpatike/ “Çdonjëri prej nesh është i bukur”</p> <p>Punë dore: “Veshjet në muajin nëntor” Edukatorët dhe fëmijët punojnë me letra/ mjete të riciklueshme/ pëlhura për të krijuar veshje të ndryshme.</p> <p>Përrallë: “Hirushja”.</p>	<p>Letra, mjete të riciklueshme, libër me përralla</p>  

<p>E Mërkurë</p>	<p>Rrobot e arushit</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve veshjet e kukullave që ndodhen në grup dhe i pyet fëmijët: Çfarë ka veshur kukulla? Identifikimi i veshjeve dhe ngjyrave.</p> <p>Loja: “Kukulla që vishet” (vishen kukullat/arushat).</p> <p>Vjersha: “Unë tani u rrita”</p> <p>Vizatim/ Ngjyrosje: “Veshje për kukulla”</p> <p>Përrallë: “Pinoku” (shoqërojmë përrallën me ndërtimin e hundës së Pinokut me kuba; foto djathtas).</p>	<p>Kukull, arush, kuba, libër</p> 
<p>E Enjte</p>	<p>Dëshirat e fëmijëve</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja pyet fëmijët: Çfarë dëshiron më shumë ti, Arba? Po ti, Drini? Çfarë lodre/ loje/ libri pëlqen ti, Adea? Po ti Ares?</p> <p>Vjersha: “Kam një kukull...”/ “Topi im”</p> <p>Punim i lirë me plastelinë/ brumë</p> <p>Loja energjike: “Me litar” (ndarja në dy grupe-vajza/djem).</p>	<p>Lodra të ndryshme në grup, libra, kukulla, topa, plastelinë/ brumë</p> 
<p>E Premte</p>	<p>Dita e Edukatores</p>	<p><i>Edukatoreset mendojnë vetë për aktivitetet që do të</i></p>	


		<p><i>organizojně sot.</i></p> <hr/> <hr/> <hr/>	
--	---	--	--






Tema e Muajit: Njohja e Vetes dhe Të drejtat e Fëmijëve

Tema e Javës: Të drejtat e fëmijëve



Java III	Tema	Aktivitetet	Mjetet
E Hënë	<p>“Të drejtat e mia”</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu flet fëmijëve për disa nga të drejtat themelore: “Ju keni të drejtë të keni një emër/ një familje/ përkujdesje nga të rriturit/ të thoni mendimin dhe dëshirat tuaja/të luani/të mos lëndoheni, etj.</p> <p>Vjersha: “Të drejtat e fëmijëve”</p> <p>Punë dore: “Pema e të drejtave”</p> <p>Lojë energjike: “Me litar/ karrige/ rrathë”</p> <p><i>(Shënim: Punimet e çdo dite, materialet dhe fotot e sjella nga prindërit do të përdoren për krijimin e një albumi ditën e premtë)</i></p>	<p>Letra me ngjyra, gërrshërë, litar/ rrathë</p>  



<p>E Martë</p>	<p>“Kam të drejtë të kem një emër”</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se kur lindim prindërit na vënë një emër. Të gjithë fëmijët duhet të thirren në emrin që kanë.</p> <p>Lojë: “Loja e telefonit” Improvizimi i komunikimit të fëmijëve me telefon duke thirrur emrat e njëri-tjetrit p.sh: Alo Mei! Alo Enis!</p> <p>Vjersha: “Të drejtat e fëmijëve”</p> <p>Vizatim i lirë (pas vizatimit, edukatorët tregojnë para grupit vizatimet e çdo fëmije duke theksuar kush e ka bërë vizatimin; “Ky është vizatimi i Megit. Sa bukur e ka ngjyrosur Amari!” Etj).</p> <p><i>(Shënim: Punimet e çdo dite dhe fotot e sjella nga prindërit do të përdoren për krijimin e një albumi ditën e premtë)</i></p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>“Kam të drejtë të kem një familje”</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu flet fëmijëve për familjen: “Të gjithë kemi një familje; kemi prindër/ motër/ vëlla/ gjysh/ gjyshe. Jo të gjitha familjet janë të njëjta, por të gjitha janë të ngrohta, na falin dashuri.”</p> <p>Vjersha: “Familja”</p> <p>Vizatim/Ngjyrosje/Punë dore: “Familja ime”</p> <p>Ekspozitë: “Familje” (me fotot e sjella nga prindërit)</p> <p>Përralla: “Mama dhia dhe kecat”.</p>	<p>Letra, lapsa me ngjyra, foto familjare, libër me përralla</p> 

<p>E Enjte</p>	<p>“Kam të drejtë të luaj”</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve që çdo fëmijë ka dëshirë dhe të drejtë të luajë. Fëmijët duhet të kenë lodra dhe hapësira për të luajtur si brenda dhe jashtë (shtëpi, çerdhe, parqe, etj). Edukatorja nxit bisedën përmes pyetjeve: Çfarë loje të pëlqen më shumë? Çfarë lodre pëlqeni më shumë?</p> <p>Vjersha: “Të drejtat e fëmijëve”</p> <p>Punim me plastelinë/brumë: Fëmijët luajnë me plastelinë/brumë duke i dhënë forma sipas dëshirës.</p>	<p>Plastelinë/brumë, lodra të ndryshme në grup</p> 
<p>E premte</p>	<p>Albumi i Të Drejtave</p>  	<p>Bisedë: Edukatorja përsërit të drejtat e mësuara gjatë javës: emri, familja, loja, etj.</p> <p>Vjersha: “Familja”/ “Të drejtat e fëmijëve”</p> <p>Aktivitet: “Albumi i Të Drejtave” Me fotot, vizatimet, punimet me plastelinë/brumë etj. edukatorja i ndihmon fëmijët të krijojnë një album të drejtash, në kapakun e të cilit vendoset një foto/ një simbol dhe emri i fëmijës.</p> <p>Lojëra të lira, kërcim.</p>	<p>Foto dhe punime të fëmijëve</p> 





Tema e Muajit: Njohja e Vetes dhe Të drejtat e Fëmijëve

Tema e Javës: Festat dhe festimi i tyre



Java IV	Tema	Aktivitetet	Mjetet
E Hënë	Njohja me festat 	<p>Bisedë: Edukatorja iu flet fëmijëve për disa nga festat kryesore që ne festojmë si: ditëlindja, 1 Qershori, Viti i Ri etj. Edukatorja shpjegon dhe pyet për ditëlindjen më të afërt të festuar prej fëmijëve ose festa të tjera.</p> <p>Vjersha: “Gëzuar ditëlindjen, Elonë”</p> <p>Këngë: “Bufi bëri dasëm” (të shpjegohet kuptimi i këngës dhe të shoqërohet më lëvizje/ të nxiten fëmijët për të imituar)</p> <p>Punë dore: “Kartolina e festave”</p> <p>Përralla: “Hirushja”.</p>	<p>Artikuj festivë (tullumbace, kapele, kartolina), libra, revista për ilustrim</p> 

<p>E Martë</p>	<p>Festimi i ditëlindjes</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve si mund të festohet një ditëlindje. Si vishemi? Çfarë dhurate i bëjmë shokut/shoqes? Si e zbukurojmë dhomën? Si argëtohemi? (Përdorim foto të ditëlindjeve të mëparshme në grup).</p> <p>Vjersha: “Gëzuar ditëlindjen, Elonë” Këngë: “Kënga e ditëlindjes” (Shumë urime për ty!) Punë dore: “Përgatisim dhurata” Edukatorja iu flet fëmijëve për rëndësinë e dhuratave për të shprehur dashurinë që kemi për njëri-tjetrin dhe bashkë me fëmijët, krijon dhurata simbolike, të thjeshta, për njëri-tjetrin, p.sh. një vizatim, një punim me plastelinë, një kartolinë, etj. Në fund të aktivitetit, krijohet një kënd i vogël me dhuratat e grupit dhe ato ruhen në grup.</p> <p>Përralla: “Bardhoshja ka ditëlindjen”</p>	<p>Fleta me ngjyra, lapsa, mjete dekorative (kopsa, fjongo), libër</p> 
<p>E Mërkurë</p>	<p>Festat e Nëntorit</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja iu flet fëmijëve për Festat e Nëntorit (në terma shumë të thjeshta, duke përdorur simbolin e flamurit, shqiponjës dhe këngët). Edukatorja pyet fëmijët për ngjyrat e flamurit.</p> <p>Vizatim/Ngjyrosja/Punim me plastelinë: “Flamuri” Lojë shpejtësie: “Ngjitja e topave në shiritin me ngjitës” (foto). Krijohen dy shirita me ngjitës dhe zgjidhen dy e nga dy fëmijët për ta bërë lojën (kush ngjit më shumë topa; shoqërojmë me numërim dhe emërtim të ngjyrave.</p>	<p>Letra, lapsa me ngjyra, topa, shirit ngjitës</p> 

<p>E Enjte</p>	<p>Zbukurimi i çerdhes për festa</p> 	<p>Punë dore: “Flamuj për festa” (shoqëruar me numërimin dhe njohja e konceptit: “i madh”/ “i vogël”).</p> <p>Aktivitet: Edukatore-fëmijë bashkarisht zbukurojnë grupet me flamujt e përgatitur, me tullumbace dhe elementë të tjerë festivë. Edukatorja shpjegon dhe bisedon me fëmijët duke pyetur për ngjyrat, numrat, etj.</p> <p>Vjersha: “Flamuri”</p> <p>Këngë dhe kërcim: “Këngët për flamurin”</p>	<p>Flamuj prej letre/rrobe, tullumbace, shirita, etj.</p> 
<p>E Premte</p>	<p>Festimi i Festave të Nëntorit</p> 	<p>Ekspozitë: “Festat” ku ekspozojmë (mbi tavolinë, në mur, në korridor etj.) punimet e javës.</p> <p>Aktivitet festiv: “Këngë, recitime, valle për Festën”.</p> <p>Sfilatë: Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit që fëmijët të vishen me veshje kuq e zi ose kostume popullore. Përgatitja e një sfilate të thjeshtë në grup.</p> 	<p>Punimet e javës, veshje kuq e zi, flamuj</p> 